



UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS
FAKULTETI I BUJQËSISË DHE MJEDISIT
Departamenti i Prodhimit Shtazor

MIRATOHET

DEKANI



Prof. Dr. Fatbardh SALLAKU

Udhëzim për zhvillimin e praktikës profesionale

për studentët që diplomohen në programin e studimit Bachelor "Zootekni dhe Biznes Blegtoral"

Përgjegjësi i Departamentit

Prof. Dr. Anila HODA

Tiranë Maj 2017

PËRMBAJTJA E LËNDËS

Të dhëna të përgjithshme	1
Qëllimet e praktikës profesionale janë	1
Përgjegjësitë e DPSH për organizimin e praktikës profesionale	1
Pedagogu i praktikës profesionale	2
Përgjegjësitë e studentit.....	2
Të drejtat e studentit.....	2
Roli i subjektit ku studenti do të kryejë praktikën profesionale.....	2
Organizimi i praktikës profesionale	3
Raporti i praktikës profesionale	3
Formati i raportit	3
Vlerësimi i raportit të praktikës profesionale.....	4
Raport (model)	5

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME

Emërtimi:	Praktikë profesionale
Drejtuesi	Anëtarët e stafit të Departamentit,
Periudha	Semestri VI
Kohëzgjatja:	5 javë
ECTS	6

- Praktika profesionale është një nga komponentët më të rëndësishëm të programit mësimor Bachelor “Zootekni dhe Biznes Blegtoral”.
- Në këtë udhëzues përcaktohen rregullat e organizimit dhe zhvillimit të praktikës profesionale.
- Praktika profesionale, mund të zhvillohet në mënyrë individuale, ose në një grup deri në 5 studentë, nën orientimin e anëtarëve të stafit akademik të DPSH, si dhe të menaxherit të kompanisë apo subjektit ku do të kryhet praktika profesionale.
- Të drejtën për të kryer praktikën profesionale e kanë studentët e vitit III, akademik Bachelor.
- Subjektet e praktikës profesionale mund të jenë FDE, fermat blegtorale, Qendrat Transferimit Teknologjive Bujqesore (QTTB), Administrata Publike, Fabrikat e Prodhimit të Ushqimeve për blegtorinë, etj.
- Praktika profesionale synon t’u japë studentëve mundësinë të fitojnë eksperiencë pune, të praktikojnë të menduarit kritik, të zgjidhin probleme reale, të zhvillojnë aftësi të reja, duke bashkëvepruar me profesionistët në subjektet e sipërpërmendura. Studenti aftësohet si të trajtojë problemet në jetën reale, të menaxhojë detyrat e tij, të identifikojë objektivat, të respektojë detyrimet, të eksplorojë ide të reja, të studjojë aspekte praktike, si dhe të marrë vendime.

QËLLIMET E PRAKTIKËS PROFESIONALE

Praktika profesionale ka për qëllim:

- Të aftësojë studentët të implementojnë në praktikë, njohuritë teorike që kanë marrë në auditor. Për këtë qëllim synohet që praktika profesionale të zhvillohet në ato subjekte që kanë lidhje të ngushtë me departamentin.
- Të nxisë studentët të zhvillojnë aftësi të reja në mjedisin ku punojnë, si dhe t’u japë atyre mundësi të përgatiten për tregun e punës dhe të bashkëveprojnë me profesionistë.

PËRGJEGJËSITË E DPSH PËR ORGANIZIMIN E PRAKTIKËS PROFESIONALE

Për organizimin dhe funksionimin e praktikës profesionale Departamenti:

- Harton listen e studentëve që do të kryejnë praktikën profesionale
- Në fillim të vitit akademik, informon studentët për detyrimin e praktikës profesionale, si dhe për mundësitë dhe subjektet që i ofron studentëve për zhvillimin e saj, duke mos përjashtuar përzgjedhjen individuale të studentëve, kur ato janë në përputhje me kuadrin ligjor.
- Përgatit programin e praktikës dhe mënyrën se si do të monitorohet procesi nga stafi i DPSH

PEDAGOGU I PRAKTIKËS PROFESIONALE

- Koordinon me studentin realizimin e programit, ndryshimet në zhvillimin e praktikës brenda limiteve të lejuara. Gjithashtu, ndihmon dhe garanton që praktika të realizohet në mënyrën e duhur
- Planifikon dhe koordinon me subjektin, zhvillimin e praktikës, sipas programit
- Në fund të praktikës, pedagogu vlerëson studentin, bazuar në raportin e vlerësimit të subjektit ku është kryer praktika, i cili ndikon në vlerësimin e vlefshmërisë së praktikës në bashkëpunim me komisionin për vlerësimin e praktikës profesionale.

PËRGJEGJËSITË E STUDENTIT

Studenti duhet:

- Të dijë rregulloren dhe programin e praktikës profesionale, si dhe dokumentat mbështetës para fillimit të praktikës.
- Të krijojë dhe ruajë marrëdhënie korekte bazuar në praktikën e mira dhe në respektin reciprok me subjektin ku kryhet praktika, kolegët dhe anëtarët e tjerë të stafit.
- Të bëjë përpjekje maksimale për të fituar njohuri teknike dhe praktike që do t'i shërbejnë në aftësimin profesional;

TË DREJTAT E STUDENTIT

Gjatë zhvillimit të praktikës studenti:

- Zgjedh subjektin individualisht, ose sipas listës së ofruar nga departamenti
- Merr pjesë aktive në aktivitetet që kanë interes teorik dhe praktik
- Apelon te subjekti, si dhe te profesori drejtues i praktikës për veprime që bien ndesh me të drejtat e tij, apo me çdo veprim tjetër që krijon vështirësi apo pamundësi për zhvillimin e praktikës.
- Studenti mund të ndyshojë subjektin vetëm pas miratimit nga pedagogu përgjegjës dhe Departamenti

ROLI I SUBJEKTIT KU STUDENTI DO TË KRYEJË PRAKTIKËN PROFESIONALE

Subjektet ndihmojnë studentin të kryejë me sukses praktikën profesionale duke:

- Zhvilluar aftësitë praktike të studentit nëpërmjet vëzhgimit, këshillimit, rekomandimeve dhe komenteve me synim formimin e tij profesional.
- I siguruar mundësitë studentit të kryejë shërbime dhe aktivitete që kryen vetë subjekti.
- I dhënë detyra studentit të rrisë njohuritë dhe aftësitë e tij profesionale.
- Ndjekur vazhdimisht studentin sipas rregullave të përcaktuara në këtë rregullore.
- Inkurajuar studentin të arrijë nivele të larta të performances.

ORGANIZIMI I PRAKTIKËS PROFESIONALE

- Praktika profesionale kryhet semestrin e gjashtë, në programin e studimit Bachelor.
- Në fillim të semestrit, departamenti informon studentët për zhvillimin e praktikës profesionale
- FBM i pajis studentët me një dokument që siguron identitetin dhe rekomandon studentin për praktikë profesionale
- Në momentin që studenti ka siguruar vendin ku do të zhvillojë praktikën profesionale, bëhet regjistrimi në Departament dhe caktohet pedagogu në rolin e supervizorit.

RAPORTI I PRAKTIKËS PROFESIONALE

Gjatë kryerjes së praktikës profesionale, studenti është i detyruar të përgatisë raportin e praktikës profesionale me njohuri dhe informacione që ka fituar gjatë saj, Në raport studentin duhet të paraqesë qëllimin e praktikës, argumentat që do jenë baza e praktikës profesionale. Në fund të praktikës profesionale, studentin dorëzon raportin, si dhe vlerësimin, apo mendimin e menaxherit të subjektit ku është kryer praktika profesionale

FORMATI I RAPORTIT

Raporti duhet të paraqitet në formë libri. Në krye të kopertinës vendoset Logo e Universitetit Bujqësor të Tiranës, si dhe poshtë saj shkruhet Emri i Universitetit Bujqësor të Tiranës, Fakultetit të Bujqësisë dhe Mjedisit dhe Departamentit të Prodhimit Shtazor. Gjithashtu, në kopertinë vendoset emri i subjektit ku është kryer praktika, titulli i temës, emri i studentit, si dhe muaji dhe viti i kryerjes së praktikës.

- **Lloji i shkrimit** sipas niveleve:
 - 1 **Titulli kryesor** ose Titulli i kapitullit: Times New Roman; Bold; 16, all capital; hanging 0.3; hapësira para dhe pas tij 12;
 - 1.1 **Niveli i parë:** Times New Roman; Bold; 14; Small capital, hanging 0.4; hapësira para dhe pas tij 6;
 - 1.1.1 **Niveli i dytë:** Times New Roman; Bold; 14; hanging 0.5; hapësira para dhe pas tij 6;
 - 1.1.1.1 **Niveli i tretë:** Times New Roman; Bold dhe italic; 14; hanging 0.6; hapësira para dhe pas tij 6;
 - Faqet e tezës duhet të formatohen si vijon
 - **Margjinat** për të gjithë tekstin do të jenë:
 - Margjina e sipërme 1”
 - Margjina e poshtme 1”
 - Margjina e majtë 1.25”
 - Margjina e djathtë 1.25”
 - Të gjithë **numrat e faqeve** duhet të vendosen poshtë dhe në mes të faqes;

- **Shënimet** duhen të bëhen me shkrim Times New Roman, 12, hapësira *single*;
- **Tabelat** të përfshihen në tekst. Tabelat duhet të vendosen në qendër të faqes, brenda margjinave të caktuara. Çdo tabelë i duhet vendosur një numër referimi që duhet të ndjekë numrin e kapitullit të cilit i përket. Fjala “Tabela”, numri i tabelës dhe legjenda duhet të vendosen në krye të tabelës. Shkrimi duhet të jetë Times New Roman, 12, bold. Nëse tabela vazhdon në faqen tjetër legjenda nuk përsëritet. Nëse një tabelë përmban citate referencat duhet të theksohen;
- **Ilustrimet dhe diagramat** duhet të skanohen dhe të inkorporohen në versionin elektronik të dokumentit. Fjala “Figura”, numri i diagramës që ndjek numrin e kapitullit të cilit i përket dhe legjenda të vendosen poshtë diagramës apo figurës. Shkrimi duhet të jetë Times New Roman, 12, bold;

VLERËSIMI I RAPORTIT TË PRAKTIKËS PROFESIONALE

Përmbyllja e praktikës profesionale bëhet nëpërmjet një prezantimi gojor, para një komisioni prej 5 anëtarësh. Prezantimi është individual ose në grup, në varësi të mënyrës si është kryer praktika profesionale. Studenti vlerësohet me notë bazuar në punën e kryer në subjektin përkatës, raportin e paraqitur, si dhe prezantimin final para komisionit.



UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS
FAKULTETI I BUJQËSISË DHE MJEDISIT
Departamenti i Prodhimit Shtazor

Raport

për praktikën profesionale pranë

"....."

Programi i studimit

"Bachelor "Zootekni dhe Biznes Blegtoral"

Tema:

"....."

Punoi

Emër Mbiemër

Tiranë, Qershor 2017